



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 224, Datë 10.07.2023

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 40, DATË 10.03.2022 “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “LAJTHIZA INVEST” SH.A. NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “QAMI 1”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1.730 MW”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 53, pika 2 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.07.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 70/8 prot., datë 07.07.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr.40, datë 10.03.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “LAJTHIZA INVEST” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Qami 1”, me kapacitet të instaluar 1.730 MW”, i ndryshuar”.

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 40, datë 10.03.2022, i ndryshuar me vendimin nr. 178, datë 18.05.2023, vendosi të licencojë shoqërinë “LAJTHIZA INVEST” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Qami 1”, me kapacitet të instaluar 1.730 MW, për një afat 30-vjeçar, duke i lënë kushtin që të depozitohet në ERE lejen e përdorimit të burimit ujqor të rinovuar jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
- ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 1397 prot., datë 26.05.2022 duke i njoftuar ndryshimin e vendimit si më sipër dhe duke i evidentuar detyrimin për të depozituar në ERE Lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor.
- Me shkresën e protokolluar në ERE nr.1397/3 prot., datë 30.05.2023 shoqëria depozitoi lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor për prodhimin energjisë elektrike nga HEC “Qami 1”, me një afat 5-vjeçar, deri më 23.02.2028.
- Me depozitim të këtij dokumenti, shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 3 të vendimit nr. 40/2022, i ndryshuar, por duke qenë se kjo leje nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit dhe, po ashtu, i nënshtrohet rinovimit, vlerësohet që kjo pikë të ndryshojë, duke i

lënë kushtin shoqërisë që të depozitohet në ERE Lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujq sipërfaqësor për prodhim hidroenergje nga HEC “Qami 1” brenda datës 23.02.2028.

- Në nenin 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: *Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Pika 3 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 40/2022, i ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:
  3. Shoqëria “LAJTHIZA INVEST” sh.a. duhet të depozitohet në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujq sipërfaqësor për prodhim hidroenergje nga HEC “Qami 1” brenda datës 23.02.2028.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “LAJTHIZA INVEST” sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**